



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5250/prot.

2

Ballsh, më 14.11.2023

**PROCES VERBAL**

**Për dëgjuesën publike me banorët e qytetit të Ballshit dhe përfaqësuesit e biznesit të vogël për Projekt-Buxhetin e vitit 2024.**

I mbajtur më datë 14.11.2023, në ambjentin e pallatit të kulturës 'Dino Kalenja', për dëgjuesën publike me banorët e qytetit të Ballshit dhe përfaqësuesit e biznesit të vogël, me temë: hartimi Paketës Fiskale 2024, Projekt-Buxheti Vjetor 2024 dhe P.B.A-në 2024-2026.

Dëgjuesën e hapi Kryetari i Këshillit **Z. Nexhmi Sulaj** duke vënë në dijeni qytetarët se sot po ju paraqesim Paketën Fiskale 2024 dhe P.B.A 2024-2026 dhe duke falënderuar ata që marrin pjesë në këtë dëgjuesë.

E merr fjalën Kryetari Bashkisë **Z. Qerim Ismailaj**, - kjo është dësgjesa e radhës, mbas asaj të mbajtur në Fratar, për banorët e Ballshit dhe përfaqësuesit e biznesit të vogël.

Duhet të jemi kontributor në miratimin e buxhetit, si bashkia ashtu dhe këshilli bashkiak, por dhe çdo sygjerim i ardhur nga banorët është i mirëpritur. Ky është viti I pestë radhazi që nuk aplikojmë rritje taksash. Janë diskutuar disa tarifa të reja për disa shërbime të cilat me vlerën e vet mbulojnë 30-40 % të punës që kryhet. Gjithashtu është menduar një rritje e tarifës së pastrimit për restorantet, supermarketet, etj.

Do të flasim sot, jo vetëm për hartimin e paketës fiskale, por dhe për të ardhurat e bashkisë.

Kjo paketë fiskale synon në:

- Hartimin e një pakete fiskale të integruar;
- Saktësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimtarive;
- Përcaktimin e saktë të gjithë elementëve të lidhur me menaxhimin.



#### Të ardhurat kryesore të Bashkisë Mallakastër:

- Tatim i thjeshtuar mbi fitimin (xhiro deri në 14 milion lekë tatami është 0 );
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja;
- Taksa e pasurisë (taksë ndërtese, taksë toke bujqësore, taksë trualli);
- Taksa për automjetet e përdorura;

#### Të ardhurat nga taksat vendore:

- Taksat mbi pasurinë e paluajtëshme;
- Taksat mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier
- Taksat mbi të ardhurat vetjake.
- Renta minerare (burimet e naftës, guroret. Disa gurore do të merren me qera nga Ndërrmarrja e Shërbimeve Publike, e cila do mundësoj paraprakisht shtrimin me çakull të disa seg. Rrugore nëpër fshatra.)

#### Në taksat mbi pasurin e paluajtëshme përfshihen:

- Taksa mbi ndërtesn;
- Taksa mbi truallin;
- Taksa mbi tokën bujqësore.

#### Taksa mbi ndërtesën aplikohet në këtë mënyrë:

- 0.05%, për ndërtesën/ njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- 0.2%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- 30% e shkallës së tokës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por nuk ka arritur të përfundojë objektin sipas afatit të lejes.

#### Pesha e taksave ndahet si më poshtë vijon:

- 32% nga të ardhurat vendore (taksë prone, taksë ndikimi ne infrastrukturë, taksë tablele);
- 12% nga taksat e ndara (taksë e kalimit të pronësisë, taksa e mjeteve të përdorura,etj)
- 56% të ardhurat nga tarifat.

#### Fusha e zbatimit të taksës së ndërtesës:

- I nënshtrohen individë, vendas ose të huaj, pronarë ose përdorues së ndërtesës;
- I nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim ndërtese;
- I nënshtrohen zhvilluesit që nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse;

#### Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtëshme llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit

#### Përfshihen nga taksat mbi ndërtesën:

- Pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- Banerat sociale në pronësi të bashkive;
- Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare;



Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie (kur familja përbëhet vetëm nga pensionist) ose pension social;

- Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike.

Taksa e ndërtesës paguhet në disa mënyra:

- familjet në qytetin e Ballshit e kanë pagesë mujore në faturën e ujit;
- biznesi i vogël e paguan në dy këste;
- biznesi i madh e paguan vjetor;
- familjet e njësive të tjera e paguajnë në faturën e taksës së tokës bujqësore.

Niveli I taksës së tokës bujqësore ndahet sipas kategorive më poshtë:

- Kategoria e I ka vlerën e taksës 2800 lekë/ha/vit;
- Kategoria e II ka vlerën e taksës 2100 lekë/ha/vit;
- Kategoria e III ka vlerën e taksës 1400 lekë/ha/vit;
- Kategoria e IV ka vlerën e taksës 1350 lekë/ha/vit, etj.

Taksa mbi truallin aplikohet si më poshtë:

- Për qëllime banimi nga individët është 0.28 lekë/m<sup>2</sup>/vit;
- Për qëllime biznesi është 15 lekë/m<sup>2</sup>/vit.

Përfshihen nga taksa e ndikimit në infrastrukturë strukturat akomoduese me pesë yje dhe subjektet të çertifikuara si agroturizëm.

Tarifat vendore të përcaktuara nga niveli qendror dhe këshilli bashkiak, përcaktohen për të gjitha shërbimet që kryhen nga bashkia. Niveli i tarifave vendoset i tillë që të mbulojë kostot e shërbimit të ofruar nga njësia e vetqeverisjes vendore. Tarifa si për zënie dhe përdorimin e hapësirës publike, tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit, etj.

Tarifat për familjet janë si më poshtë:

Ballshi	Njësiti e tjera
- Tarifë pastrami (largimi I mbetjeve) 2000 lekë /vit	- 1000 lekë /vit;
- Tarifë gjelbërimi 500 lekë/vit	- 250 lekë /vit;
- Tarifë ndriçimi 1000 lekë/vit	- 500 lekë /vit.

Këto tarifa do të aplikohen në njësitë dhe nëndarjet e tyre ku ofrohen shërbimet nga bashkia Mallakastër. Detyrimi është vjetor.

Përfshihen nga tarifat familjare:

- Familjet e individëve të punës e të luftës;
- Familjet që kanë në përbërjen e tyre të paaftë (PAK);
- Familjet që kanë në përbërje të tyre të verbër, paraplegjikë ose tetraplegjikë;
- Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike;



- Familjet që kanë statusin e të përndjekurve politik;  
Familjet e veteranëve të luftës,  
- Dhe çdo familje për të cilat është marr vendimi, nga këshilli bashkiak, për përjashtimin nga tarifatat vendore.

Tarifatat e pastrimit për bizneset e vogëla:

Ushqimore, bulmetore, dyqane mishi e peshku	8000 lekë
Hidrosanitare, pajisje elektro-shtëpiake	10000 lekë
Artikuj të ndryshëm industrial	8000 lekë
Restorante	25000 lekë

Për subjektet e regjistruar rishtazi detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit në QKB.

Tarifa e ndriçimit për biznesin e vogël , për njësi tregëtare, shërbimi, prodhimi do të jetë 3000 lekë/vit. Detyrimin të pagesës së kësaj tarife i nënshtrohen të gjithë subjektet ku ofrohet ky shërbim.

Tarifatat që mbeten të njëjta si vitin e kaluar janë:

- Tarifa e ndotjes;
- Tarifa për përdorimin e tregjeve të lira;
- Tarifa për përdorimin e ujëmbledhësave;
- Tarifatat për përdorimin e ambjenteve kulturore dhe sportive.

Për mosshlyerjen në afat të detyrimeve aplikohen gjobat dhe kamatvonesat.

Këtu mbaron dhe prezantimi i paketës Fiskale, kush ka pyetje ose sygjerime, jeni të mirëpritur. Asnjë nga të pranishmit nuk ka pyetje ose sygjerime, si përfaqësues të biznesit të vogël ndhe nga qytetarët.

**Z. Qerim Ismailaj** – Kalojmë në pikën e dytë të dëgjësës, që është prezantimi i: P.B.A 2024-2026, në të cilin bën pjesë dhe project buxheti për vitin 2024.

Kemi pasur një nevojë ekstreme për të lidhur fshatrat me qytetin, duke investuar në projektet rrugore. Kemi realizuar shtrimin e 50 km rrugë të shtruara, duke ruajtur balancën ekonomike të bashkisë dhe sot jemi një bashki me zero debi. Por kemi në vëmendje të hyjmë dhe në infrastrukturën e rrugëve të tokave bujqësore, pastrimet e kanaleve të kullimit, duke vepruar paralelisht me Ndërrmarrjen e Shërbimeve Publike. Në këtë mënyrë planifikojmë shpërndarjen e të ardhurave për të gjitha zonat e banimit.

Burimet e të ardhurave:

- Burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, nga tarifatat vendore dhe të ardhura që trashëgohen;



- Grantet e projekteve të huaja dhe donacionet;
- Burimet qëndrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuara.

#### Burimet e financimit të buxhetit 2024

- Të ardhura të trashëguara nga viti 2023;
- Transfertat e pakushtëzuara
- Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore;
- Transfertat sektoriale (arsimi, MNZ, pyjet, rrugët etj.);
- Fonde të deleguara, etj.

#### Disa tregues të rëndësishëm për buxhetin:

- Të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2024, zënë mesatarisht 37% të totalit të buxhetit;
- Transfertat e pakushtëzuara për vitin 2024, zënë mesatarisht 20% të totalit të buxhetit;
- Transfertat e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2024, zënë mesatarisht 15% të totalit të buxhetit;
- Transferta e kushtëzuar për vitin 2024, zënë mesatarisht 28% të totalit të buxhetit.

#### Prioritet e Bashkisë Mallakastër për vitin 2024 janë:

- Zhvillimi urban (përmirësimi i infrastrukturës rrugore, zhvillimi i zonave periferike, krijimi i hapësirave publike);
- Zhvillimi social-ekonomik (mbështetja e biznesit me politika fiskale, gjallërimi i jetës sociale dhe kultura, mbështetja për krijimin e tregjeve dhe orientimi për shitjen e produkteve);
- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi (menaxhimi i mbetjeve urbane, eliminimi i ndotjes nga ujërat e zeza);
- Zhvillimi i infrastrukturës dhe shërbimeve (ndërrhyrje në sistemin e kullimit, shtimi i sipërfaqeve pyjore, garantimi i shërbimit zjarrfikës, etj).

#### Mbrojtja e mjedisit:

- Menaxhimi i mbetjeve urbane;
- Menaxhimi i gjelbërimit të qytetit;
- Eliminimi i ndotjes nga ujërat e zeza;
- Mbështetje për rehabilitimin e shesheve nga facilitetet e abandonuara të industrisë së hidrokarbureve ndër vite.

#### Invenstimet kryesore në infrastrukturën rrugore:

- Objekte të cilat janë në përfundim:
  - Rikonstruksioni i rrugës Diga e rezervuarit – Anabregë – Kutë – Çorrush.
  - Rikonstruksioni i rrugëve në fshatrat Visokë – Dukas – Greshicë – Mollaj.
- Objekte në process që vazhdojnë dhe në 2024:
  - Rikonstruksioni i rrugës Panahor – Ngraçan dhe rruga Ballsh – Drenovë e Re.

- Rikonstruksioni i rrugëve Rromës – Qafa e Drenovës, Fratar – Drizar, Ninsh – Nenaj – Damës.

Investimet në ujësjellës:

- Ndërtimi i ujësjellesit Drenovë – Belishovë – Belishovë e Re – Visokë

Vazhdon të jetë në process rehabilitimi i ujësjellësit të qytetit të Ballshit dhe ndërtimi i linjës së transmetimit nga burumi i Poçemit – Ballsh.

Ky ishte dhe prezantimi i P.B.A 2024-2026 dhe P.B 2024, kalojmë te vrejtitet dhe sygjerimet tuaja.

Faleminderit!

**Z. Maks Goxhaj** – me kaq sa dëgjuam në këtë dëgjes, për sa i përket shifrave, duhet kohë për analizimin e tyre, kurse për sa i përket qytetit të Ballshit jemi të vetëdijsëm që është rritur ndërgjegjësimi për punët e kryera. Por them se bashkia duhet të marr masa për disa punime të kryera nga ujesjellësi dhe për cilësinë e tyre. E dyta, rruga nga Ballshi deri te varrezat që kur është shtruar tortuari dhe rruga, janë bërë pa kanalizime dhe sa herë që bie shi uji ngelet në rrugën kryesore. Këto kisha dhe punë të mbarë për vitin 2024!

**Z. Qerim Ismailaj** – për sa i përket ujësjellësit, ka ngelur në process ndërrimi i matësave të ujit.

Sa i përket rrugës jemi në process për alokim fondesh për rrugën Patos – Ballsh, në të cilën bën pjesë dhe aksi që ju përmendët, sepse nuk mund të prishim një punë të kryer nga dikush tjetër, dhe pse jo Brenda standarteve.

**Z. Skënder Muharremaj** – jam me parimin që të kemi taksa më të ulëta, duke u bazuar në të ardhurat mesatare mujore për familje. Për shembull taks jo e njëjtë si për atë që ka të ardhura mujore 70000 lekë/muaj dhe për atë me 15000 lekë /muaj.

Për sa i përket infrastrukturës, lagjia ku unë banoj, rruga është bërë gjithë gropa dhe kanale. Pa kaluar te rrugët e fshatrave, mendoj se duhet bër më parë rruga Ballah – Fratar, e cila është një rrugë që I shërben pastër Mallakastrës.

Për sa i përket buxhetit mendoj se duhet investuar më tepër për arsimin, biblioteket, etj, sepse një qytet pa bibliotekë është si një trup pa shpirt..

**Z. Qerim Ismailaj** – sa i përket taksave, jemi përpjekur të aplikojmë të njëjtin nivel taksash me vitiet e kaluara. Ka një sërë kategorish që lehtësohen nga tarifat, kurse elementi rrogë (të ardhura mujaore /familje) te shërbimi që kryhet për çdo familje. Shërbimi i pastrimit është i njëjtë si për atë që ka të ardhura 10000 lekë/muaj dhe për atë që i ka të ardhurat 15000 lekë/muaj, sepse ndotja konsiderohet e njëjtë nga të dyja familjet. Por ajo çfarë ngelet e rëndësishme është pastry,i i mbetjeve në kohë.

Lidhur me arsimin jemi koshient që duhet bërë më tepër, por jemi para faktit të rënies drastike të numrit të nxënësve. Por aktualisht investohet për nxënësit dhe të rinjtë duke realizuar aktivitet që mendoj se kanë shumë peshë për ta.

Aksi rrugor Ballsh – Fratar i përket ARRSH-së, dhe është një aks, që dhe sikur të duam, rikonstruksionin e saj nuk e mbulon dot buxheti i bashkisë, por dhe financimet kur vijnë janë të drejtuara për projekte të ndryshme, p.sh për parkun arkeologjik Bylis, etj.

**Z. Flori** – mendoj se disa fshatra janë anashkaluar, për shembull, zona ku unë banoj (Kash) shkolla është mbyllur, por peshën më të madhe duhet ta ketë punësimi, sepse largimi i familjeve ndodh për mungesë të ardhurash, mendoj që duhet të nxisim bizneset e reja qoftë dhe duke i përjashtuar nga taksat për pak muaj. Në administrat mund të punoj ai që ska asnjë person në punë, them se këto duhet të jenë fokuset kryesore të bashkisë.

**Z. Qerim Ismailaj** – pëqë secilin nga ne qendra e botës është shtëpia e vet, lagjia e vet dhe zona ku banojmë, mirëpo investimet duhen në të gjitha zonat. Para pak kohësh së bashku me N.Sh.P-në realizuam shtrimin e një rruge me çzkull në Kash.

Në Këshillin Bashkiak kemi miratuar, për disa biznese që operojnë me më pak se 30 punonjës, të jenë të përjashtuar nga disa taksa për tre vitet e para, për t'i lehtësuar dhe për tq nxitur ounësimin.

Punësimi në administrat është sipas ligjit dhe kualifikimeve arsimore që kanë punëmarrsit.

Shkolla, në zonën ku ju banoni, është mbyllur fillimisht për shkak të amortizimit të godinës, ndërsa sot, dhe të duam të ndërtojmë një godinë të re që ta rihapim, nuk mundemi sepse nuk plotësohet numri i nxënësve.

Faleminderit!

**MBAJTËS I PROCESVERBALIT**

**Sekretare Këshillit**

**Zinaida Ahmetaj**

